



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT - OPŠTINA OBILIĆ
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-Izlazno

Nr. 1-35
Br.

Data 28.03.2023
Datum

OBILIĆ - OBILIĆ

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obilić

Në mbështetje të nenit 12.1, nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c), nenit 58 shkronja (h) dhe dhe nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare nr.28 e dt.04.06.2008), neni 27 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 34 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 72, pika 1.8 dhe nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës së Obiliqit, nr.I-34, i dt.25.04.2016, si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës nr.-II-268, të dt.21.03.2023, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për Njësinë Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin

Neni 1

Miratohet Vendimi për Shpalljen e interesit të përgjithshëm për shpronësimin e Njësisë Kadastrale si në vijim :

- **P-72602052-00804-26**, Zona: Rural; Lloji i Shfrytëzimit të parcelës: Bujqësore; Shfrytëzimi aktual i parcelës: Arat; Kualiteti i klasës: Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 310 m²; Pjesa e Pronës 1/1; Vendi i quajtur: Utrina Utrina; e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH. BUJQËSIA** .

Neni 2

Qëllimi i paraqitjes së këtij Vendimi për Shpalljen me Interes të Përgjithshëm Publik të njësisë kadastrale të cekur si në nenin 1 të këtij Vendimi është Shpronësimi i kësaj Njësie Kadastrale për nevoja të Komunës së Obiliqit, në të cilat planifikohet realizimin e projekteve të ndryshme .

Vlera e kompensimit për pronën që do të shpronësohet do të caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015, për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme, që do të shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin .

Neni 3

Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronë dhe Kadastër, në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 do t'i drejtohet Qeverisë së Republikës së Kosovës (Departamentit të Shpronësimit) për fillimin e procedurës së shpronësimit.

Neni 4

Pas miratimit të këtij Vendimi për zbatimin e tij do të kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronë dhe Kadastër dhe Drejtoria e Financave .

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokolit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

-T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DPUKP
- MAPL
- Arkivit



Kryesuesja e Kuvendit Komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi